

VENDIM
Nr. 719, datë 2.9.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE TË HERCEGOVINËS, PËR
LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË QYTETARËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe të Hercegovinës, për lëvizjen e ndërsjellë të qytetarëve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

**MBI NDRYSHIMET E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE TË
HERCEGOVINËS MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË QYTETARËVE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe i Hercegovinës, të quajtura “Palët Kontraktuese”,

në zbatim të nenit 11, paragrafit 2 të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe të Hercegovinës mbi lëvizjen e ndërsjellë të qytetarëve, të nënshkruar në Sarajevë, më 24 mars 2009;

me dëshirën për të lehtësuar lëvizjen e ndërsjellë të qytetarëve,
kanë rënë dakord për ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Paragrafët 2 dhe 3, të nenit 1, kanë ndryshuar formulimin si më poshtë:

“2. Qytetarët e Palës Kontraktuese, mbajtës të një dokumenti të vlefshëm udhëtimi dhe të dokumenteve të tjera të përmendura në shtojcën e kësaj marrëveshjeje, janë të lirë për të hyrë dhe për të qëndruar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese pa vizë deri maksimumi 90 (nëntëdhjetë) ditë në një periudhë kohore prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e hyrjes së parë, ndërsa gjatë kësaj periudhe ata nuk mund të kryejnë asnjë aktivitet tregtar apo profesional.

3. Qytetarët e Palës Kontraktuese, mbajtës të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit dhe të dokumenteve të tjera të përmendura në shtojcën e kësaj marrëveshjeje mund të hyjnë, të qëndrojnë, të largohen ose të kalojnë transit përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese në pikat e kalimit kufitar të hapura për kalim ndërkombëtar.”.

Neni 2

Neni 4 hiqet.

Neni 3

Neni 8 ndryshon formulimin si më poshtë:

“1. Palët Kontraktuese shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, modele të dokumenteve të

vlefshme të udhëtimit dhe dokumenteve të tjera të përmendura në shtojcën e kësaj marrëveshjeje, të paktën 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Në rast se një nga Palët Kontraktuese lëshon dokumente të reja udhëtimi dhe dokumente të tjera të përmendura në shtojcën e kësaj marrëveshjeje ose modifikon dokumentet e shkëmbyera më parë, Pala tjetër Kontraktuese njoftohet për ndryshimet e lartpërmendura, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para zbatimit. Njoftimi duhet të përmbajë modele të të dhënave të dokumenteve të reja ose të modifikuara për zbatimin e tij.”.

Neni 4

Shtojca e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe të Hercegovinës për lëvizjen e ndërsjellë të qytetarëve ndryshon formulimin si më poshtë:

“Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, dokumentet e mëposhtme të udhëtimit dhe dokumente të tjera konsiderohen si të vlefshme:

1. Për qytetarët e Republikës së Shqipërisë:

a) Pasaporta e një qytetari të Republikës së Shqipërisë, që konfirmon identitetin e një qytetari të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit;

b) Kartë marinari (Karta e Identitetit të Marinarit) dhe të jetë mbajtësi i një dokumenti për anijen ose certifikatën e saj;

c) Dokument udhëtimi për hyrje (kthim) në Republikën e Shqipërisë (vetëm për kthim në Republikën e Shqipërisë);

d) Deklarata e Përgjithshme (misioni ajror), në të cilën janë shënuar anëtarët e ekuipazhit të aeroplanit të aviacionit civil të Palëve Kontraktuese;

e) Kartë Identiteti Biometrike e qytetarit të Republikës së Shqipërisë, e cila konfirmon identitetin e një qytetari të Republikës së Shqipërisë.

2. Për qytetarët e Bosnjës dhe të Hercegovinës:

a) Pasaportë e një qytetari të Bosnjës dhe të Hercegovinës që konfirmon identitetin e një qytetari të Bosnjës dhe të Hercegovinës jashtë vendit;

b) Kartë marinari (Karta e Identitetit të Marinarit) dhe të jetë mbajtësi i një dokumenti për anijen ose certifikatën e saj;

c) Dokument udhëtimi për hyrje (kthim) në Bosnjë dhe në Hercegovinë (vetëm për kthim në Bosnjë dhe në Hercegovinë);

d) Deklarata e Përgjithshme (misioni ajror), në të cilën janë shënuar anëtarët e ekuipazhit të aeroplanit të aviacionit civil të Palëve Kontraktuese;

e) Kartë Identiteti Biometrike e qytetarëve të Bosnjës dhe të Hercegovinës, e cila konfirmon identitetin e një qytetari të Bosnjës dhe të Hercegovinës.”.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje zbatohet përkohësisht nga data e nënshkrimit dhe hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit, me anën e të cilit Palët Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi.

Hartuar në Tiranë, më 30.7.2015, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, boshnjake, kroate, serbe dhe angleze, ku secili prej këtyre teksteve është njëlloj autentik. Në rast mos-përputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.